

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 615/1 Prot.

Tiranë, më 09/04/2026

VENDIM

Nr. 33, datë 09/04/2026

PËR

**DHËNIEN E TITULLIT “DOCTOR HONORIS CAUSA” Z. JOSÉ MANUEL CIRIA**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun V, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, në nenin 24, pika 1, germa “ff” të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresën nr. 586 prot., datë 17.03.2026 të Fakultetit të Arteve të Bukura, nëpërmjet së cilës përcillet propozimi për dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa”, z. José Manuel Ciria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe shqyrtimit e diskutimit nga ky Senat,

VENDOSI:


1. T’i japë titullin “Doctor Honoris Causa” z. José Manuel Ciria, me motivacionin: *“Për kontributin e tij të shquar në zhvillimin dhe promovimin e artit bashkëkohor, për krijimtarinë e tij të spikatur në fushën e pikturës abstrakte, për ndikimin dhe praninë e veprës së tij në institucione dhe koleksione prestigjioze ndërkombëtare, si dhe për rolin frymëzues që praktika dhe reflektimi i tij artistik përfaqësojnë për komunitetin akademik dhe brezat e rinj të artistëve”.*
2. Të caktojë reçentë Prof. Asoc. Dr. Zef Paci dhe Prof. Asoc. Edmond Gjipopulli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion SHIMA

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE  
KËRKIMIT SHKENCOR  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. 2305 / prot.

Tiranë, më 01.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje

UNIVERSITETIT TË ARTEVE  
Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, Tiranë

Në vijim të shkresës suaj nr. 618 Prot., datë 24.03.2026 me lëndë "Mbi dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" z. José Manuel Ciria", administruar në Ministrinë e Arsimit me nr. 2305 Prot., datë 25.03.2026; ju informojmë se:

Ministria e Arsimit, në zbatim të pikës 1, të kreut V, të vendimit nr. 112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", të ndryshuar, jep pëlqimin për dhënien nga institucioni juaj, të titullit "Doctor Honoris Causa" për z. José Manuel Ciria.

Në vijim, ju njoftojmë se, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, për vitin 2026, pas dhënies së titullit të sipërcituar, ju keni në dispozicion dhënien e 1 (një) titulli tjetër "Doctor Honoris Causa" për vitin 2026.

Duke ju falënderuar,

ZËVENDËSMINISTËR

Armela Bako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI

Nr. 586 Prot.

Tiranë, më 14.03.2026

**Lënda:** Përcillet propozimi i Njesisë Bazë Pikturë dhe Vendimi i Dekanatit për dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" z. José Manuel Ciria

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**  
**Prof. Dr. Erald Bakalli**

*I nderuar z. Rektor,*

Bashkëngjitur kësaj shkrese po Ju përcjellim propozimin e Njesisë Bazë Pikturë për dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" z. José Manuel Ciria si dhe Vendimin nr. 1, datë 14.03.2026 të Dekanatit të Fakultetit të Arteve të Bukura mbi këtë propozim.

Duke shpresuar në mbështetjen e kërkesës sonë,

Me konsideratë,

DEKANI

Prof. Sadik Spahija





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANATI

Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 14.03.2026

VENDIM

Nr. 1, datë 14.03.2026

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TË PROPOZIMIT TË NJËSISË BAZË PIKTURË, PËR  
DHËNIEN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" Z. JOSÉ MANUEL CIRIA**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" si dhe të Vendimit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve nr. 19, datë 17.04.2025 "Për miratimin e rregullores për akordimin e titujve akademikë "Profesor emeritus" dhe "Doctor Honoris Causa", pas njohjes me dokumentacionin dhe diskutimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të propozimit të Njesisë Bazë Pikturë, për dhënie e titullit "Doctor Honoris Causa" z. José Manuel Ciria.
2. Vendimi, bashkë me propozimin e Njesisë Bazë Pikturë dhe dokumentacionin shoqërues t'i përcillen Rektorit të Universitetit të Arteve për procedurë të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof. Sadik Spahija



ZËVENDËSDEKAN

Prof. Asoc. Albes Fusha

DREJTUESI I NJËSISË BAZË PIKTURË

Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

DREJTUESI I NJËSISË BAZË ARTE TË APLIKUARA

Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

DREJTUESI I NJËSISË BAZË SKULPTURË

Prof. Asoc. Genc Mulliqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
NJËSIA BAZË PIKTURË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**Lënda:** Propozohet dhënia e titullit “Doctor Honoris Causa” z. José Manuel Ciria

**DEKANATIT TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA**

*Të nderuar kolegë,*

Njësia bazë “Pikturë” ka miratuar në mënyrë unanime propozimin për dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa” artistit të shquar José Manuel Ciria.

Bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Curriculum Vitae të artistit,
2. Deklaratën në formën e pëlqimit nga ana e tij,
3. Motivacionin për dhënien e këtij titulli,
4. Rekomandimet nga Prof. Asoc. Edmond Gjipopulli dhe Prof. Asoc. Dr. Zef Paci,
5. Relacionin nga Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo.

Duke shpresuar në vlerësimin tuaj pozitiv të këtij propozimi,

Me konsideratë,

**PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË**

**Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo**



## José Manuel Ciria

José Manuel Ciria është një nga artistët më të shquar të brezit të tij dhe një figurë kyçe në panoramën heterogjene të pikturës spanjolle gjatë tre dekadave të fundit. Që nga viti 1984, kur realizoi ekspozitën e tij të parë personale në galerinë Ferrière në Paris, Ciria ka zhvilluar një karrierë të gjerë dhe është nderuar me çmime dhe ekspozita të shumta. Në vitet e fundit ai ka fituar njohje të gjerë ndërkombëtare përmes ekspozitave personale në Herzliya Contemporary Art

Museum në Tel Aviv, Izrael (2002), Tretyakov State Gallery në Moskë, Rusi (2004), Muzeun Kombëtar të Polonisë në Varshavë (2004), Museo de Arte Abstracto Manuel Felguérez në Zacatecas, Meksikë (2005), PasquArt Kunsthalle Art Center Museum në Bernë, Zvicër (2005), Museo de Arte Contemporáneo Ateneo de Yucatán në Mérida, Meksikë (2006), Museo Nacional de Bellas Artes në Buenos Aires, Argjentinë (2007), Museo de Arte Contemporáneo në Santiago de Kilit (2009) dhe Instituto Valenciano de Arte Moderno (IVAM) (2010), ndër shumë institucione të tjera muzeale.

Pas periudhës së tij të hershme të lidhur me figuracionin ekspresionist, në fillim të viteve '90 José Manuel Ciria konsolidoi programin e tij poetik abstrakt karakteristik, i cili bazohej në dialogun midis rrjedhës së pakontrolluar të njollës dhe rigorozitetit të gjeometrisë. Ky program përbënte një ripërcaktim kritik të dy mjeteve themelore të estetikës abstrakte të shekullit XX. Megjithatë, interesimi i artistit për larminë e regjistrave ikonografikë, si dhe eksperimentimi i tij i vazhdueshëm me materiale dhe mbështetje të ndryshme, iu shtuan shpejt këtij programi fillestar. Nga kombinimi i këtyre mundësive, dhe i ushqyer nga një model i fortë konceptual, gjatë viteve '90 José Manuel Ciria krijoi shumë seri, boshtet kryesore tematike të cilave ishin koha dhe kujtesa.

Periudha e re që Ciria nisi në New York në fund të vitit 2005 përbën një pikë të re nisjeje në veprën e tij. Ajo shënoi një proces "ftohjeje" në mënyrën e pikturimit, përmes rikthimit të vijës si strukturë kompozicionale dhe stabilizimit të mëvonshëm të një ikonografie të paqartë, e vendosur në një pikë të ndërmjetme midis figuracionit dhe abstraksionit. Në veprat e tij më të fundit, artisti rikthen dhe intensifikon dy ekstremet e fjalorit të tij abstrakt: njolla bëhet më e lirë, më intensive dhe dramatike, ndërsa rigoroziteti konstruktiv i gjeometrisë së sfondit bëhet më i theksuar.

Në lidhje me veprën e Ciriës, kritiku i njohur amerikan Donald Kuspit është shprehur: "Do të guxoja të thosha se José Manuel Ciria është një piktor i madh. Me këtë dua të them se ai ka një zotërim të plotë të mediumit dhe të mjeteve të tij: bojës dhe fjalorit gjestual dhe gjeometrik të abstraksionit modernist... Në pikturat e Ciriës mund të shohim qartë një element të fortë fantazie, siç tregojnë figurat e tij. Ndoshta ai mund të quhet një iluzionist abstrakt, në kuptimin që krijon figura fantastike nga elemente abstrakte, zakonisht plane gjestuale që duken në lëvizje të vazhdueshme dhe që sugjerojnë një figurë në mes të një procesi metaforik."

José Manuel Ciria lindi më 3 shkurt 1960 në Manchester, nga prindër spanjollë (Santiago dhe Gloria), dhe qëndroi në Angli deri në moshën tetëvjeçare, kur prindërit e tij vendosën të ktheheshin në Madrid. Që në fëmijëri Ciria shfaqti talent për vizatimin dhe pikturën dhe pasi ndoqi disa shkolla dhe punëtori në Círculo de Bellas Artes, ai u regjistrua në Departamentin e Arteve të Bukura në Universitetin e Madridit. Në vitin e dytë të studimeve universitare, Ciria vendosi të largohej nga universiteti dhe të studioje në mënyrë të pavarur. Në vitin 1994 ai fitoi Bursën e Parisit nga Ministria e Kulturës dhe në vitin 1995 Bursën e Romës nga Ministria e Punëve të Jashtme. Në vitin 2001 ai mori gjithashtu një bursë nga Ministria e Kulturës dhe Shkencës e Izraelit për përgatitjen e dy ekspozitave muzeale në Tel Aviv.

Gjatë karrierës së tij profesionale Ciria ka marrë gjithashtu shumë çmime, ndër të cilat: Çmimi i 23-të "City of Alcalá" në Alcalá de Henares, Çmimi Plástica Contemporánea në Vitoria-Gasteiz, Konkursi i 3-të Ndërkombëtar i Pikturës Fundación Barceló në Palma de Mallorca, Konkursi Kombëtar "Ciudad de Alcorcón" në Madrid, Bienalja e 5-të e Kajros (Medalja e Artë – Çmimi i Parë nga Juria Ndërkombëtare), Ekspozita e Parë Bienale e Artit në Alcoi, Konkursi Kombëtar i Pikturës Iberdrola-UEx në Cáceres, Çmimi Kombëtar i Pikturës për 400-vjetorin, Kolegji i Avokatëve të Madridit, Konkursi Kombëtar i Vizatimit Fundación Gregorio Prieto në Valdepeñas, Saloni i Vjeshtës i Akademisë Mbretërore të Arteve të Bukura të Galicias në La Coruña, Konkursi Kombëtar Caja de Madrid, Çmimi i 14-të Kombëtar i Pikturës, Trienalja e 2-të Ndërkombëtare e Grafikës në Kajro (Çmimi i Parë i Jurisë Ndërkombëtare), Saloni i 11-të i Vjeshtës i Caja de Extremadura në Plasencia, Saloni i LXVI i Vjeshtës i Shoqatës Spanjolle të Pikturës dhe Skulpturës në Madrid (Çmimi "Reina Sofía" për Arritje të Jashtëzakonshme), Bienalja e 2-të e Artit Rafael Botí në Córdoba, Ekspozita Kombëtare e 60-të e Arteve të Bukura në Valdepeñas (Çmimi i Parë – Medalja e Ekspozitës së Parë), Ekspozita e 6-të Unión Fenosa në La Coruña, Konkursi i Parë i Pikturës Fundación Nicomedes García Gómez në Segovia, Çmimi Kombëtar i Gravurës i Museo del Grabado Español Contemporáneo në Marbella, si dhe Çmimi i Parë Ndërkombëtar për Dekorimin më të Mirë të një Kishe nga revista Wallpaper.

## DECLARATION OF CONSENT


I, José Manuel Ciria, hereby declare that I am deeply honored by the proposal of the University of Arts in Tirana to confer upon me the title of Doctor Honoris Causa.

Through this statement, I express my full consent and acceptance of this distinction. I sincerely appreciate the recognition granted by the University of Arts and consider it a great privilege to be associated with such an esteemed academic and artistic institution.

I am also grateful for the opportunity to strengthen the cultural and artistic dialogue between our communities.

Date: Madrid, May 11th 2026

Signature:

A rectangular area containing a handwritten signature in black ink on a light gray background. The signature is cursive and appears to read 'José Manuel Ciria'.

José Manuel Ciria



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
NJËSIA BAZË PIKTURË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**Lënda:** Propozohet dhënia e titullit “Doctor Honoris Causa” z. José Manuel Ciria

**DEKANATIT TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA**

*Të nderuar kolegë,*

Njësia bazë “Pikturë” e Fakultetit të Arteve të Bukura, vendosi t’i propozojë Dekanatit të këtij fakulteti dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa” z. José Manuel Ciria me këtë motivacion:

*“Për kontributin e tij të shquar në zhvillimin dhe promovimin e artit bashkëkohor, për krijimtarinë e tij të spikatur në fushën e pikturës abstrakte, për ndikimin dhe praninë e veprës së tij në institucione dhe koleksione prestigjioze ndërkombëtare, si dhe për rolin frymëzues që praktika dhe reflektimi i tij artistik përfaqësojnë për komunitetin akademik dhe brezat e rinj të artistëve”.*

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË**

**Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
NJËSIA BAZË PIKTURË**

**REKOMANDIM  
për dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa”  
z. José Manuel Ciria**

José Manuel Ciria konsiderohet një nga figurat më të rëndësishme të pikturës bashkëkohore spanjolle dhe një ndër përfaqësuesit më të spikatur të zhvillimit të artit abstrakt në skenën ndërkombëtare gjatë dekadave të fundit. Përmes një veprimtarie të pasur dhe të qëndrueshme artistike, ai ka zhvilluar një gjuhë vizuale të veçantë, e cila ndërthur kërkimin konceptual dhe atë teknik në drejtimin e pikturës abstrakte.

Krijimtaria e tij karakterizohet nga një proces i vazhdueshëm kërkimi, që reflektohet në zhvillimin e shumë serive piktorike. Veprat e tij nuk përfaqësojnë një evolucion linear, por një proces kompleks zhvillimi ku koncepti, materiali dhe struktura kompozicionale ndërthuren në mënyrë dinamike. Përmes kësaj praktike ai ka arritur të kontribuojë në pasurimin e diskursit estetik të artit abstrakt bashkëkohor.

Veprat e José Manuel Ciria janë preyantuar në institucione prestigjioze muzeale dhe artistike në Europë, Amerikë Latine dhe në vende të tjera të botës, ndërsa krijimtaria e tij është pjesë e koleksioneve të rëndësishme publike dhe private ndërkombëtare.

Krijimtaria dhe përvoja artistike e José Manuel Ciria përbën gjithashtu një burim të rëndësishëm frymëzimi dhe reflektimi për komunitetin akademik dhe artistik në Shqipëri. Praktika e tij e vazhdueshme kërkimore në territoret abstrakte, si dhe qasja e tij eksperimentale ndaj gjuhës së pikturës, përfaqësojnë një model të rëndësishëm edhe për studentët dhe pedagogët e Universitetit të Arteve, në drejtim të zhvillimit të mendimit kritik dhe të kërkimit të formave të reja të shprehjes vizuale.

Duke vlerësuar kontributin e tij të veçantë në zhvillimin e artit bashkëkohor dhe në promovimin e dialogut kulturor ndërkombëtar përmes artit, mbështes propozimin që Universiteti i Arteve t'i akordojë artistit José Manuel Ciria titullin “Doctor Honoris Causa”, si shenjë vlerësimi për veprën dhe ndikimin e tij në zhvillimin e arteve pamore në nivel ndërkombëtar.

**Prof. Asoc. Edmond Gjipopulli**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI I ARTEVE**  
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**  
**NJËSIA BAZË PIKTURË**

**REKOMANDIM**  
**për dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa”**  
**z. José Manuel Ciria**

Kam kënaqësinë të shpreh mbështetjen time për propozimin që Universiteti i Arteve t'i akordojë titullin “Doctor Honoris Causa” artistit të njohur spanjoll José Manuel Ciria, në vlerësim të kontributit të tij të rëndësishëm në zhvillimin e artit bashkëkohor dhe në veçanti të pikturës abstrakte.

José Manuel Ciria është një nga artistët që kanë ndërtuar një gjuhë të veçantë vizuale të artit bashkëkohor ndërkombëtar, duke zhvilluar një praktikë artistike që ndërthur eksplorimin konceptual me intensitetin material të pikturës. Vepra e tij shquhet për energjinë, për përdorimin ekspresiv të bojës dhe për një kërkim të vazhdueshëm mbi marrëdhënien ndërmjet strukturës dhe spontanitetit. Krijimtaria e tij bazohet në traditën e ekspresionizmit abstrakt, por njëkohësisht e tejkalon atë përmes një qasjeje personale bashkëkohore ndaj gjuhës së pikturës.

Ai ka zhvilluar një praktikë artistike të karakterizuar nga transformime të vazhdueshme formale dhe konceptuale, kjo edhe për shkak të lëvizjeve gjeografike, nga Madridi, ku u formua dhe nisi veprimtarinë e tij artistike, e më tej përgjatë viteve të krijimtarisë në New York, Berlin dhe Londër.

Karriera artistike e José Manuel Ciria është zhvilluar e promovuar në qendra të rëndësishme të artit ndërkombëtar. Ekspozitat e tij janë mbajtur në institucione të rëndësishme muzeale dhe artistike në Europë dhe më gjerë, duke shërbyer si dëshmi për rëndësinë dhe ndikimin e tij në skenën bashkëkohore të arteve pamore. Përmes veprës së tij, José Manuel Ciria ka kontribuar në rigjallërimin e debatit mbi rolin dhe potencialin e pikturës në artin bashkëkohor, duke afirmuar pikturën si një medium ende të fuqishëm dhe të hapur ndaj formave të reja të interpretimit.

Prania dhe vlerësimi i një artisti si José Manuel Ciria do të përbënte jo vetëm një vlerësim për kontributin e tij artistik, por edhe një mundësi për ndërtimin e urave të bashkëpunimit midis një figure kaq të rëndësishme të artit bashkëkohor dhe komunitetit akademik e artistik të Universitetit të Arteve. Për këto arsye, mbështes plotësisht propozimin që Universiteti i Arteve t'i akordojë José Manuel Ciria titullin “Doctor Honoris Causa”.

**PROF. ASOC. DR. ZEF PACI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
NJËSIA BAZË PIKTURË**

**RELACION MBI VEPRIMTARINË DHE KONTRIBUTIN E ARTISTIT  
JOSÉ MANUEL CIRIA**

José Manuel Ciria konsiderohet një nga figurat më të rëndësishme të pikturës bashkëkohore spanjolle dhe një ndër përfaqësuesit kryesorë të zhvillimeve të artit abstrakt në skenën artistike ndërkombëtare në dekadat e fundit. Veprimtaria e tij artistike është karakterizuar nga një kërkim i vazhdueshëm estetik dhe konceptual, i cili ka kontribuar në pasurimin dhe ripërcaktimin e gjuhës së pikturës abstrakte në kontekstin bashkëkohor.

Në fazat e hershme të krijimtarisë së tij, Ciria u lidh me figuracionin ekspresionist. Në fillim të viteve '90 ai konsolidoi një program të veçantë poetik abstrakt, i cili bazohej në dialogun midis rrjedhës spontane dhe të pakontrolluar të njollës dhe rigorozitetit të gjeometrisë. Ky dialog midis gjestit dhe strukturës përbën një riformulim kritik të dy prej elementeve themelore të estetikës abstrakte të shekullit XX. Përmes kësaj qasjeje, artisti zhvilloi një gjuhë vizuale të veçantë ku dinamika e materies piktorike ndërthuret me strukturën kompozicionale, duke krijuar një tension mes këtyre elementeve.

Krijimtaria e José Manuel Ciria karakterizohet gjithashtu nga një interes i vazhdueshëm për eksperimentimin me materiale dhe teknika. Ai ka zhvilluar një gamë të gjerë regjistrash ikonografikë dhe formash vizuale. Gjatë viteve '90 ai realizoi një numër të madh serish piktorike, ku temat kryesore lidheshin me konceptet e kohës dhe kujtesës, duke trajtuar me qasje filozofike përvojën njerëzore.

Një moment i rëndësishëm në zhvillimin e tij artistik ishte periudha e qëndrimit në New York, pas vitit 2005. Në këtë fazë të krijimtarisë së tij, Ciria rikthen vijnë si element strukturues të kompozimit dhe zhvillon një ikonografi që qëndron në një pikë të ndërmjetme midis figuracionit dhe abstraksionit. Kjo qasje e re shënon një evolucion të mëtejshëm të diskursit të tij piktorik.

Në vitin 2013, pas një periudhe qëndrimi në Berlin, artisti u vendos në Londër, ku zhvilloi serinë "The London Boxes", e cila përfaqëson një etapë të re në kërkimin e tij artistik. Në këtë seri ai fillon të konceptojë strukturën e përgjithshme të pikturës si rezultat të një sistemi vendimesh të ndërjegjishme kompozicionale, ku vizatimi dhe struktura lineare bëhen elemente qendrore të ndërtimit të imazhit piktorik. Gjatë kësaj periudhe ai realizoi njëkohësisht vepra me elemente figurative dhe kompozime plotësisht abstrakte, duke eksploruar kufijtë dhe ndërthurjet midis këtyre dy dimensioneve të gjuhës vizuale.

Pas rikthimit të tij në Madrid në vitin 2015, Ciria zhvilloi një seri të re piktorike të titulluar "Procedures". Në këtë seri veprat nuk ndërtohen mbi një metodë të vetme kompozicionale, por mbi kombinimin e një spektri të gjerë teknikash. Kjo qasje dëshmon për një inventar të gjerë teknikash dhe metodash piktorike që artisti ka zhvilluar gjatë karrierës së tij, duke eksploruar pothuajse çdo mundësi të aplikimit të bojës mbi sipërfaqe të ndryshme.

Veprimtaria artistike e José Manuel Ciria karakterizohet gjithashtu nga një karrierë e gjatë dhe e konsoliduar në nivel ndërkombëtar, e cila përfshin ekspozita të shumta personale dhe kolektive në institucione prestigjioze muzeale dhe artistike, si dhe praninë e veprave të tij në koleksione të rëndësishme publike dhe private.

Përgjatë karrierës së tij profesionale, Ciria ka fituar një njohje të gjerë ndërkombëtare përmes ekspozitave të organizuara në muze dhe institucione të rëndësishme kulturore në Europë, Amerikë Latine dhe më gjerë. Ndër institucionet ku janë prezantuar veprat e tij përfshihen Herzliya Contemporary Art Museum në Tel Aviv, Tretyakov State Gallery në Moskë, National Museum of Poland në Varshavë, Museo de Arte Abstracto Manuel Felguérez në Zacatecas të Meksikës, PasquArt Kunsthalle Art Center në Bernë, Museo Nacional de Bellas Artes në Buenos Aires, Museo de Arte Contemporáneo në Santiago de Kilit, si dhe Instituto Valenciano de Arte Moderno (IVAM) në Spanjë. Ekspozitat e tij janë organizuar gjithashtu në institucione të tjera të rëndësishme si Heritage Museum (MUPAM) në Malaga, National Museum of Contemporary Art (MINAC) në Bukuresht dhe Museum of Modern Art (MAMBA) në Buenos Aires. Përveç prezantimit të veprave të tij në hapësira muzeale dhe galeri ndërkombëtare, krijimtaria e José Manuel Ciria është pjesë e koleksioneve të rëndësishme institucionale dhe private. Ndër to përfshihen Museo Nacional Centro de Arte Reina Sofía në Madrid, Instituto Valenciano de Arte Moderno (IVAM), Muzeu Komunal i Artit Bashkëkohor në Spanjë, si dhe Muzeu Albertina në Vjenë. Prania e veprave të tij në këto institucione dëshmon për rëndësinë dhe ndikimin e krijimtarisë së tij në skenën bashkëkohore të artit.

Rezultatet e punës së tij artistike reflektohen gjithashtu në zhvillimin e një sërë serish piktorike që përfaqësojnë etapa të ndryshme të kërkimit të tij estetik dhe konceptual. Nga seritë e hershme të viteve '90, të ndërtuara mbi dialogun midis spontanitetit të njollës dhe strukturës gjeometrike, deri te seritë e mëvonshme si "The London Boxes" dhe "Procedures", krijimtaria e tij dëshmon për një evolucion të vazhdueshëm artistik.

Veprimtaria e gjerë artistike e José Manuel Ciria, ekspozitat ndërkombëtare, prania e veprave të tij në koleksione prestigjioze dhe ndikimi i tij në diskursin artistik bashkëkohor përbëjnë dëshmi të rëndësishme të rezultateve të punës së tij në fushën e arteve pamore. Përmes krijimtarisë së tij ai ka kontribuar në promovimin e artit bashkëkohor në nivel ndërkombëtar dhe në zhvillimin e dialogut kulturor ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve artistike të vendeve të ndryshme.

#### PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË



**Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo**